

VENDIM
Nr. 14, datë 7.5.2024

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e Informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar; në kreun I, të nenit 22, pika 4, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, të ndryshuar; në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, të kryetarit të Autoritetit, “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, i ndryshuar me urdhrin nr. 56, datë 23.3.2023, “Për një ndryshim në urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, ‘Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 14, datë 7.5.2024, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Arkiva e Autoritetit, Fondi të Arratisur, dosje formulare nr. 2542, në ngarkim të D. N. K., me 41 (dyzet e një) fletë. Dosja daton në vitet 1945–1959. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
2. Arkiva e Autoritetit, Fondi operativ, dosje formulare nr. 3279, në ngarkim të L. Z. J., me 37 (tridhjetë e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1960–1980. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
3. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Korçë, dosje pa nr., “Për të arratisurit”, me 34 (tridhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1985–1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.
4. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Pogradec, regjistër nr. 35, “Për shkelësat e kufirit”, me 98 (nëntëdhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitin 1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.
5. Arkiva e Autoritetit, Fondi Ushtria, dosje nr. 672, “Dosje e objektit të rëndësisë së veçantë për Brigadën 157”, Korçë, me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1986–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.
6. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Korçë, dosje nr. 16/1, “Indeksi i të arratisurve” me 234 (dyqind e tridhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1944–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.
7. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Ersekë, dosje pa nr., dosar me lista të të arratisurve, me 148 (njëqind e dyzet e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1945–1977. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.
8. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Korçë, dosje nr. 402, “Mbi të arratisurit dhe kulakët”, me 211 (dyqind e njëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1973. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.
9. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Ersekë, dosje nr. 136, “Për të arratisurit”, me 56 (pesëdhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1986–1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.
10. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Ersekë, dosje nr. 155, “Për të arratisurit”, me 45 (dyzet e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1985–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

11. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Ersekë, dosje nr. 153, “Për të arratisurit”, me 31 (tridhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitet 1983–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

12. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Ersekë, dosje nr. 154, “Për të arratisurit”, me 26 (njëzet e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1985–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

13. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Ersekë, dosje nr. 152, “Për të arratisurit”, me 49 (dyzet e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1985–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

14. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Ersekë, dosje nr. 196, “Për të arratisurit”, me 65 (gjashtëdhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1985–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

1. Arsyeja e deklasifikimit të dokumenteve të sipërcituara është:

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit 45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në nenin 22, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, si dhe në vendimin e Autoritetit nr. 31, datë 24.1.2023, pika 1 të dispozitivit.

2. Ngarkohet Sekretari i KDZH-së të bëjë evidentimet përkatëse në regjistër, të vendosë vulën përkatëse mbi dokumentet e deklasifikuara dhe të hartojë bibliografinë e informacionit të deklasifikuar.

3. Kopja e bibliografisë së informacionit të deklasifikuar t’i dërgohet zyrtarisht Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

4. Të bëhet publikimi i dokumenteve të deklasifikuara në faqen zyrtare të internetit të AIDSSH-së dhe në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KDZH-së
Gentiana Sula